



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:032235  
Datë: 05.12.2023  
Numri i dokumentit: 05016625

C-IV.-13-3535

*Ankuesi:*

**NA** –Prizren.

*Kundër*

*E Paditura:*

**N. SH. “IFS Progres”-Prizren**, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP),  
Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me datë 05 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ034-0311 i dt. 28 tetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 03 dhjetor 2013, ankuesi parashtroj ankesë - kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. PRZ-0311 të datës 28 tetor 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për 3 paga të papaguara në shumë prej 1,000.00 € nga N. SH. “IFS Progres”-Prizren (në likuidim). Ankuesi e kundërshtuar vendimin e AL, si jo të drejtë dhe jo ligjor. Ankuesi i ka propozuar Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar. Ankuesi si dëshmi ka bashkangjitur në kopje vendimin e kundërshtuara dhe një listë pagesë për muajin prill 2007.

Me 27 gusht 2018, e padituri në mbrojtjen e tij të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP pohoi se ankuesi nuk ka prezantuar fakte edhe në kuptim të nenit 7 të Ligjit mbi procedurën kontestimore ku theksohet se “palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. E paditura i ka kërkuar gjykatës që të refuzoj ankesën dhe të vërtetoj vendimin e AL.

Me 03 shtator 2018, gjykata i ka dorëzuar mbrojtjen e AKP-së tek ankuesi.

Me 27 shtator 2018, ankuesi ka paraqitur një përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)*”, ndërsa pika 3 parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë*”.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara në shumë prej 1,000.00 € (njëmijë euro), të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e N.Sh-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për

pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

E paditura në vendimin e saj Nr. PRZ034-0311, me të cilën ka refuzuar kërkesën e ankuesit në pjesën arsyetuese kur i është referuara nenit 40.1.61 të shtojcës së ligjit të AKP-së nuk ka mohuar se punonjësve u takojnë 3 pagat e fundit sipas prioriteteve të cilëve mund ti kenë mbetur të papaguara nga N.SH, por ka arsyetuar se *“kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes”*, gjë që ankuesi nuk e ka bërë.

Gjykata vëren se ankuesi kërkesën për kompensimin e 3 pagave të papaguara, në shumë prej 1,000.00 €, nuk e ka mbështetur me asnjë provë para AL prandaj vendimi i AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Ankuesi edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH. “IFS Progres” i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit dhe Listë-pagesa për muaji prill 2007, nuk janë dëshmi me të cilat dëshmohet e N.Sh i ka mbetur borxh ankuesit. Listë-pagesa për muajin prill 2007, nuk është listë me të cilën dëshmohet se e paditura i ka mbetur borxh ankuesit, por është vetëm një listë pagesë me të cilën konfirmohet listë-pagesa per periudhën prill 2007. Madje në këtë listë shihet se ankuesi ka pasur pagën bruto prej 100 €, ndërsa për 3 paga kërkon shumën prej 1,000.00 €, prandaj edhe në këtë aspekt ankesa e tij është e pabazuar.

Ankuesi edhe me përgjigjen ndaj mbrojtjes së të paditurës, ka dështuar që të dorëzoj prova me të cilat do të dëshmohej se NSH i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara, andaj Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tre paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është i liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit nuk e kalon vlerën mbi 1000 €.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, gjyqtar